



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.275/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ali Nimanaj, kandidat për kryetar të Komunës së Istogut nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitur kundër komisionerëve të Qendrës Komunale të Numërimit (QKN), në Istog, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me **22.10.2025**, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e parashtruar nga Ali Nimanaj, kandidat për kryetar të Komunës së Istogut nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitur kundër komisionerëve të Qendrës Komunale të Numërimit (QKN), në Istog, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 20.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit Ali Nimanaj nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se me datë 15.10.2025, në QKN Istog, janë vërejtur parregullsi nga ekipi numërues apo bartësi i rezultateve finale në sistem, për numrin e votave në kutinë 0620/01 në Llukac i Begut, nuk përputhen mes vete, sepse Partia Demokratike e Kosovës për kryetar ka marrë në rezultatet preliminare kemi pasur 70 vota ndërsa në rezultatet nga QKN kemi 58 vota. Andaj, parashtruesi i ankesës kërkon që ky detaj të rregullohet.

Në përgjigjen në ankesë të datës 20.10.2025, Komisioni Qendror Zgjedhor kanë deklaruar se të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, theksojnë se pretendimet e palës ankuese se i janë ndryshuar votat gjatë procesit të numërimit në fazën e futjes së të dhënave në sistem në QKN,

lidhur me vendvotimin 0620/01, për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës, të datë 12 tetor 2025 ka njoftuar se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar me 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore nr.16/24 për Qendrat Komunale të Numërimit. Tutje KQZ ka theksuar se rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimeshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështesin pretendimet e saj të paraqitura në ankesë.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, si dhe përgjigje në ankesë ka gjetur se:

- Ankesa është e pabazuar

Në bazë të provave të bashkangjitura shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, paneli vlerësoi se pretendimet ankimore të ankuesit Ali Nimanaj, kandidat për kryetar të Komunës së Istogut nga subjekti politik i PDK, janë të pabazuara për faktin se e njëjti nuk ka arritur që të vërtetoj, përkatësisht të dëshmoj faktin se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e saj, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë të vetme dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e saj se ka ndodhur një veprim i tillë në QKN në Istog. Kurse pretendimet e theksuara më shumë janë supozime se sa thënie të dokumentuara në fakte dhe në prova konkrete.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht” dhe Neni 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Ali Nimanaj, kandidat për kryetar të Komunës së Istogut nga radha e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është e pabazuar, pasi që nuk ka bashkangjitur asnjë provë, përkatësisht pretendimi për parregullsi gjatë futjes së të dhënave dhe rezultateve në (QKN) në Istog, se shfletimet dhe regjistrimi në sistem të votave të kandidatëve nuk përputheshin mes vete, mbetet vetëm i natyrës deklarative dhe se nuk është mbështetur me asnjë provë që do të dëshmonte pretendimet ankimore. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Kështu që Paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve, konstatoi se dëshmitë e ofruara nuk janë të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se pretendimi i parashtrueses se ankesës se ka 58 vota, ndërsa duhet të ketë 70 vota, nuk është dëshmuar me prova nga pala ankuese, andaj në rrethanat e rastit konkret ankesa është refuzuar si e pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar në nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL.Anr.275/2025 datë 22.10.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.